

## Raport Muaji Shtator 2019

### Informacion bazë

Menaxhimi i Fondit	<b>Raiffeisen INVEST</b>
Monedha	<b>Euro</b>
Datë Lancimi	<b>22 Nentor 2012</b>
Vlera fillestare e kuotës	<b>100</b>
Shuma fillestare minimale	<b>250</b>
Shuma minimale pasuese	<b>50</b>
Komision në hyrje	<b>0.00%</b>
Komision në dalje	<b>0.00%</b>
Komision Administrimi në vit	<b>1.50%</b>
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	<b>Referojuni informacionit ne deget e RBAL</b>

### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në perputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.

Nje pjese e rendesishme e asetëve të fondit mund të investohen në bono dhe obligacione thesari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të emetuara në monedhën euro. Megjithatë, frekuenca e emetimeve në euro nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përcaktoje shkallën në të cilën Fondi do të investojë në këto lloj instrumentash.

Fondi është i pershtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmeritë e tyre.

### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët  
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë  
Përfitimet tipike më të larta



### Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e dytë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

## Të dhëna për Fondin në 30.09.2019


<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>€ 80,538,283.51</b>
<b>Numri i Investitoreve</b>	<b>3,148.00</b>
<b>Cmimi i Kuotes</b>	<b>€ 119.6117</b>
<b>*Kthimi vjetor nga investimi (30.09.2018-30.09.2019)</b>	<b>3.35%</b>

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e Portofolit të investimeve në 30 Shtator 2019

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur rrezikun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Përqindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kriterëve të specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.




Obligacionet të quajtura “dytësore” (ose me termin financiar subordinated) janë afërsisht 5% e portofolit në fund të muajit Shtator. Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit në datën 30 Shtator 2019, pjesa e asetëve të fondit të investuara në obligacione qeveritare qendron në 44.45% të asetëve dhe afërsisht 30% e tyre i përkasin emetimeve të Qeverisë Shqiptare, ndërsa 10.2% janë obligacionet të emetuara nga institucione financiare. Fondi mund të balancojë ekspozimin në instrumente të ndryshme në varesi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë.

Përqindja e alokimit të asetëve në depozita afatshkurtra është 6% e asetëve të fondit, ndërsa pjesa e asetëve të fondit të investuar në Fonde investimi qendron në 28.6% e totalit të asetëve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. 21% e asetëve të fondit janë investuar në obligacione të korporatave me vleresim rating të lartë.

Vlera neto e asetëve të fondit është relativisht e qëndrueshme, në nivelin e 80.54 milionë Euro në fund të muajit Shtator.

### Perberja e portfolit sipas instrumentave




### Performanca e fondit ne Shtator 2019

Gjate muajit Shtator, Fondi Euro pati nje renie te lehte mujore prej 0.23%, kjo si pasoje e levizjes normale te tregjeve te obligacioneve. Ne vlere absolute nga fillimi i vitit fondi rezulton me nje fitim 3.98%. Renie e normave te interesit ka ndikuar pozitivisht ne rritjen e cmimit te obligacioneve ne portofolin e fondit.


Zbatimi i politikave lehtesuese nga ana e Bankave Qendrore ne Europe dhe SHBA, duke ulur normat e interesit dhe shtuar stimujt lehtesues per ekonomite e vendeve te tyre ka nje efekt te drejtperdrejte ne performancen e fondit. Per momentin normat ne Europe priten te jene stabel per shkak se Banka Qendrore Europiane (BQE) sapo ka ulur normen e depozites me 10 pike baze gjate muajit Shtator, ndersa per tregjet Amerikane pritesmerite jane qe normat te ulen ende me tej ne takimet e ardhshme te Bankes Qendrore Amerikane (FED) pergjate vitit 2019.

### Performanca e Fondit Raiffeisen Invest Euro gjate vitit 2019



Çmimi i kuotes se fondit eshte rritur mesatarisht me 2.65% qe nga fillimi i tij ne vitin 2012. Në datën 30 Shtator 2019, kthimi neto është 1.39% (norme me baze vjetore) për investitorët që janë 3 vjet në fond dhe 2.31% (normë me baze vjetore) për investitorët që janë 5 vjet në fond.

Çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Lulahshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur. Kështu ne inkurajojmë investitorët të kenë një horizont sa më të gjatë investimi, në mënyrë që të përfitojnë kthimin maksimal nga investimi, dhe të mos rrezikojnë duke dalë nga fondi në momentin e gabuar. Portofoli i fondit Euro mund të ripozicionohet për të adresuar zhvillimet më të fundit të tregjeve financiare.



## Informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare për muajin Shtator

Normat e interesit të obligacioneve në tregjet ndërkombetare pesuan një rritje të lehtë gjatë muajit Shtator, pasi kishin arritur nivelet më të ulëta në fund të muajit Gusht dhe si gjithnjë vendimarrjet e Bankave Qendrore në lidhje me politikën e tyre monetare kanë ndikuar në regjimet e tregjeve.

Kështu Banka Qendrore Europiane (BQE), njoftoi në mes të muajit Shtator një valë të re masash stimuluese për të ndihmuar zhvillimin e ekonomisë së Eurozonës. BQE vendosi uljen e normës së depozitës me 0.10% në nivelin -0.50% dhe njoftoi rinisjen e programit të blerjes së titujve në 01 Nentor me vlerën 20 Miliarde euro në muaj për një afat kohor të papercaktuar derisa norma e inflacionit të jete afër objektivit prej 2.00%. Nderkohe niveli i inflacionit vjetor për zonën euro pësoi rënie në 0.9%, i nxitur nga rënia e çmimeve të energjisë dhe është tashmë shumë larg objektivit të synuar.

Siç pritej, Banka Qendrore Amerikane (FED) uli normën e interesit me 25 pike baze në intervalin 1.75% - 2.0% dhe sipas saj ekonomia amerikane vazhdon të tregojë rritje të moderuar por solide.

Rreziku më i madh politik mbetet lufta tregtare midis dy ekonomive më të mëdha SHBA dhe Kinë, dhe pritshmerite janë shtuar për një marrëveshje të mundshme gjatë muajit Tetor. Por përveç tensioneve tregtare dhe pasigurisë për ceshtjen Brexit, e cila mund të shtyhet përtej 31 Tetor 2019, rreziqe të reja politike janë shtuar sic janë sulmi ndaj njëres prej fabrikave më të rëndësishme në botë për përpunimin e naftës në Arabinë Saudite, e shoqëruar me rritje të perkohshme të çmimit të naftës me 20% si dhe fillimi i procesit të hetimit nga ana e Kongresit Amerikan mbi marrëdhëniet e Presidentit Trump me Ukrainën dhe mundësinë për shkarkimin e tij.

Rritja ekonomike globale vijoi të tregojë shenja ngadalesimi dhe në Europë shifrat janë me të dukshme sidomos në vende si Gjermania. Ndersa në Amerikë Banka Qendrore ka ende hapësirë për të vepruar përmes stimuljeve monetare, në zonën Euro duket se BQE nuk mund të bëjë më gjë dhe se stimujt fiskalë të shteteve anetare mund të jenë suportuesit e radhës për të stimuluar rritjen ekonomike dhe inflacionin.

Tregu i obligacioneve vijon të jete i luhatshem dhe dominojnë normat negative të interesit, nderkohe që vijon të ketë kërkesë të larta për obligacionet me nivel vlerësimi të ulët (high yield) dhe që mund të prodhojnë yield pozitiv.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjere numerike, janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm janë të fuar të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit.

Raiffeisen Invest dhe bankieret e Raiffeisen Bank nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al), ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.